

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti për Krime të Rënda, kryetarja e trupit – gjyqtarja Ajser Skenderi, me procesmbajtësin Leutrim Braha, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. S. nga Prizreni, për shkak të veprës penale të falsifikimit të parasë nga neni 302 par.3 të KPK, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë themelore në Prizren-repartamenti për krime të rënda PP/I n.42/18, të datës 24.04.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit të dytë, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Mehdi Sefa, si dhe të akuzuarit, më datën 20.06.2018. muarr dhe publikisht e shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B. S., nga i ati N. dhe e ëma Z. – e lindur R., i lindur më *data e lindjes...* në fshatin R. Komuna e Prizrenit, ku edhe tani jeton, e ka të kryer shkollën fillore, me profesion punëtor, i martuar, i ati i tre fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Se më datën 08.03.2018 rrethë orës 18:30 minuta, në Prizren në bankomatit me nr.ATM BA 500065 në Njësinë e bankës NLB e cila ndodhet në rrugën .. me dije deponon 100 Euro me nr.serik L 11810076593 në xhirrollogarinë e mikut të tij A. D. në bankomatit e NLB, e cila bankënotë pas ekzaminimit ka rezultuar si e falsifikuar.

Këso dore ka kryer veprën penale falsifikimi i parasë nga neni 302 par.3. të KP.

Andaj, gjykata konformë nenit 7, 17, 41, 49, 50, 51, 52, 62 par.2.pika.2.6. në lidhje me nenin 302 par.3. të KP, e gjykon me :

D Ë N I M M E K U S H T

Ashtu që, ia cakton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 /tre/ muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në kohën e verifikimit prej 1 /një/ viti nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Nga i akuzuari B. S. konfiskohet bankënota prej 100 Euro me nr.serik L.11810076593 si mjet i kryerjes së veprës penale.

Obligohet i akuzuari që në emër paushalit gjykatës të ia paguaj shumën prej 30 Euro në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore – në Prizren Departmenti për Krime të Rënda, me aktakuzën PP/I nr.42/18, të datës 24.04.2018, ia vë në barrë të akuzuarit B. S., veprën penale të falsifikimit të parasë, nga neni 302 par.3. të KPK. Gjatë shqyrtimit të dytë, pasiqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë Prokurori i Shtetit Mehdi Sefa, ka propozuar që pranimin e gajësisë gjykata ta merr si rrethanë lehtësuese gjatë matjes së dënimit dhe tia shqiptoj një dënim sa më të butë. Poashtu si dënim plotësuar ka propozuar konfiskimin e bankënotës.

I akuzuari i ka propozuar gjykatës që të i shqiptoi një dënim sa më të butë pasiqë është hera e parë që ka ra në konflikt me ligjin, se është i martuar dhe i ati i tre fëmijve dhe i premtion gjykatës se tani e tutje më nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngajshme.

Në bazë të lartcekurave, e duke marr parasysh pranimin e fajësisë nga i akuzuarit, i cili pranim është bërë konform nenit 248 të KPP, pasi që i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, gjithashtu pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime teknike, gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit Burim Sali, krijohen elementet qenësore të veprës penale të falsifikimit të parasë nga neni 302 par.3. të KPK-së, si në dispozitiv të aktgjykimit, pasiqë i njëjti më datën 08.03.2018 rrethë orës 18:30, në Prizren, në rrugën ... – në bankomatin me nr. ATM BA 500065, në Njësinë e Bankës NLB, i akuzuari me vetëdije deponon valutën prej 100 euro, me numër serik L11810076593, në xhirrollogarinë e mikut të tij A. D., në bankomatin e NLB e cila banknotë pas ekzaminimit ka rezultuar e falsifikuar. .

Andaj, duke marr parasysh të lartcekurat, gjykata edhe e shpalli të akuzuarit B. S., fajtor për veprën penale të falsifikimit të parasë nga neni 302 par.3 të KPK, duke ia shqiptuar dënimin me kusht, sepse konsideron se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj ia cakton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 /tre/ muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në kohën e verifikimit prej 1 /një/ viti, nuk kryen ndonjë vepër të re penale, pasi që paraprakisht gjykata vërtetoi se i akuzuari, është penalo-juridikisht përgjegjës.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin konformë nenit 41 të KP, përkitazi me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në të njëjtën duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rritjen e dënimit, shkallën e përgjegjësisë, dhe motivet nga të cilat është kryer vepra, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP-së, të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, konform nenit 74, gjykata si rrethanë lehtësuese mori parasysh qëndrimin korrekt të të akuzuarit në gjykim, pranimin e fajësisë për veprën penale, faktin se në të kaluarën ka qenë i padënuar dhe është hera e parë që bie në konflikt

me ligjin, gjykata ka marrë parasysh edhe pendimin dhe shprehjen e keqardhjes nga i akuzuari, dhe se pas kryerjes së veprës penale që i ngarkohet, ai nuk kanë rënë në konflikt me ligjin. Pasiqë rrethana rënduese nuk gjeti gjykata është e mendimit se dënimi i këtillë i shqiptuar si në dispozitiv është në harmoni me intensitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, me shkallën e përgjegjesisë penale të akuzuarit, dhe se me këtë do të mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KP, dhe se do të mundësoj një balanc të drejtë në mes të kërkesave që të akuzuarit, t'i mundësohet risocializimi dhe kërkesës së shoqërisë që ai dënim me peshën e tij të ketë karakter të përgjithshëm parandalues nga kryerja e veprave penale, të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit të respektimit të ligjit. Gjukata vendosi për këtë lloj të dënimit pasi që krijoi bindjen se i akuzuari në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të tjera penale dhe se është mendimi i gjykatës se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjesisë së tij, dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe që të përmbahet, nga veprimet e tilla apo të ngjajshme.

Nga të lartcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për konfiskimin e bankënotës është marrë konform nenit 62 pa.2 pika 2.6 të KP.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 450 par.2, nën par.2.6. të KPP.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti për Krime të Rënda
Më datë 20.06.2018 P.nr.34/18

Procesmbajtësi:
Leutrim Braha

Kryetarja e trupit gjykues:
Ajser Skenderi

KËSHILLA JURIDIKE: Pasiqë palët me të drejtë ankese kanë hjek dorë nga e drejta e ankesës,ky aktgjykim me ditën e shpalljes-me datën **20.06.2018** bëhet i plotëfuqishëm.